

VENDIM
Nr. 506, datë 10.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 745, DATË 5.9.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E QENDRËS SHUMËFUNKSIONALE TË ARSIMIT
DHE FORMIMIT PROFESIONAL NË KAMZË DHE FUNKSIONIMIN E SAJ GJATË
PERIUDHËS KALIMTARE
2013 – 2018”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “b”, të nenit 7, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 745, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 3, emërtimi “...Ministria e Arsimit dhe Shkencës...” zëvendësohet me “...ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...”.

2. Në pikën 4, emërtimi “...ministri i Arsimit dhe Shkencës...” zëvendësohet me “...ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...”.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Statuti i QSHAFF-së, për periudhën kalimtare, miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.”.

4. Pika 7 ndryshohet, me këtë përmbytje:

“7. Gjatë fazës kalimtare bordi i QSHAFF-së quhet bordi i drejtimit. Detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen në statutin e QSHAFF-së, përshtatur gjatë kësaj faze sipas kërkesave të veçanta të saj.

Bordi i drejtimit të QSHAFF-së Kamzë përbëhet nga:

- a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) një përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale përkatëse;
- c) dy përfaqësues nga sektori privat, që lidhet me profilet që ofron QSHAFF-ja;

ç) një përfaqësues i Bashkisë Kamzë;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të shkollës;

dh) një përfaqësues nga organizatat ose programet ndërkombëtare që mbështetin teknikisht dhe financiarisht QSHAFF-në.

Kjo përbërje e bordit do të jetë deri në përfundim të fazës kalimtare.”.

5. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bordit të drejtimit dhe sekretariatit të tij përcaktohen në statutin e QSHAFF-së.”.

6. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. QSHAFF-ja Kamzë ka të drejtë të kryejë veprimtari ekonomike me përfitime financiare, në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve dhe praktikave mësimore, dhe të përdorë, në mënyrë të pavarur, 100 % të të ardhurave që rezultojnë nga këto aktivitete. Tarifat për shërbimet që do të ofrojnë QSHAFF-ja Kamzë miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Realizimi i veprimtarisë ekonomike bëhet nëpërmjet kontratave të rregullta me personat fizikë dhe juridikë palë, ku të drejtat dhe detyrimet e palëve janë të përcaktuara qartë. Të ardhurat e krijuara nga

veprimtaria ekonomike taksohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Edhe dhurimet, financimet e huaja dhe burime të tjera të kësaj natyre administrohen 100 % nga QSHAFP-ja Kamzë, sipas planit të administrimit të kësaj kategorie financimesh, të miratuar nga bordi i drejtimit.”.

7. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Struktura dhe organika e QSHAFP-së miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, brenda numrit të punonjësve të miratuar për Shkollën e Mesme Profesionale Kamzë.”.

8. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të parashikuara për mbulimin e pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimet për blerje materiale shërbimesh si dhe fondet për investime, që nga data 1 janar 2015 të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike.”.

9. Pika 17 shfuqizohet.

10. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama